REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 11
Datë/Datum 01. 02. 2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

---

**Datë: 01.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 29, të datës 15.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mbështetur në kërkesën Nr. 27 të datës 14.01.2016, e parashtruar nga 'CARITAS KOSOVA', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Aprovohet propozimi, Nr. 29, i datës 15.01.2016, për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 242,847.76€, për vazhdimin e realizimit të projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'CARITAS KOSOVA'.

2. Shuma e mjeteve financiare nga buxheti i komunës, për vazhdimin e realizimit të projektit sipas pikës një (1) të vendimit, lejohet nga kodet ekonomike të projekteve si vijon:

2.1 Nga kodi i projektit, Nr. 612180-1627895 për mirëmbajtje, pastrim të ambientit, ngritja e përkujdesit social, shëndetësor, shtëpiak, ambulantor, administrativ, ekonomik, infrastrukturor e tjera, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 200,000.00€;

2.2 Nga kodi i participimit bashkëfinancim i projekteve, Nr. 612175-1523702, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 22,818.76€.

3. Për vazhdimin e realizimit të projektit, sipas pikës një (1) të vendimit, 'CARITAS KOSOVA', financon me mjete financiare në shumë prej 20,030.00€.

4. Me vazhdimin e realizimit të këtij projekti për periudhën njëvjeçare, duke filluar nga data 01.02.2016-31.01.2017, ndihmohen qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës:

4.1 Shërbimet sociale edukative dhe shëndetësore, për përmirësimin e kushteve të varfërisë për shtresat sociale;

4.2 Vazhdimin e përkrahjes financiare të punësimit të qytetarëve të komunës tonë, punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative;

4.3 Parandalimi i procesit të migrimit ilegal nëpërmjet krijimit të vendeve të punës;

4.4 Përkujdesje sociale dhe shëndetësorë për familjet e komuniteteve: rom, ashkalinj dhe egjiptian.

5. Kryerja e procedurave tjera dhe sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës (2) të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financa e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

6. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet:** **Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së ARSIM, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

____________________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Nr. 12
Data 01.02.2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 01.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 21, të datës 11.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (c dhe ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2015, në shumë totale prej 60,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore në kodet e programeve si vijon:

1.1 Mjetet financiare në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim nga kategoria ekonomike buxhetore 30 investime kapitale, programi 'Buxhet dhe Financa 17502', projekti 'bashkëfinancimi në projekte 40081', me numër 21/612/17502/30/40081/0490;
1.2 Mjetet financiare në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim nga kategoria ekonomike buxhetore 30 investime kapitale, programi 'Buxhet dhe Financa 17502', 'projekti 'blerja e automjeteve 40084', me numër 21/612/17502/30/40084/0451;
1.3 Shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim nga kategoria ekonomike buxhetore 13 mallra dhe shërbime, programi 'Arsimi 92010', me numër 21/612/92010/13/00000/0900;
1.4 Shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim nga kategoria ekonomike buxhetore 13 mallra dhe shërbime, programi 'Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale 73011', me numër 21/612/73011/13/00000/0700.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së ARSIM-it, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

_______________

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS - REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 13
Datë/Datum 01. 02. 2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 01.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 17, të datës 14.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (c dhe ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

## VENDIM

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare, në shumë prej 384,000.00€, nga 'Kodi i participimit, subvencioneve dhe transfereve', për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga buxheti i komunës si vijon:

1.1 Mjetet financiare në shumë prej 100,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e serrave';
1.2 Mjetet financiare në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 14,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e gjedhave';
1.3 Mjetet financiare në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e latofrizave';
1.4 Mjetet financiare në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e pulave';
1.5 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 2,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e makinave mjelëse';
1.6 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 2,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e spërkatësve të krahut';

1.7 Mjetet financiare në shumë prej 30,000.00€, nga buxheti i komunës, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e fidaneve';

1.8 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 2,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e inkubatorëve';

1.9 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e folive plastike';

1.10 Mjetet financiare në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e koshereve për bletë';

1.11 Mjetet financiare në shumë prej 80,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 16,000.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e kultivatorëve';

1.12 Mjetet financiare në shumë prej 19,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 3,800.00€ ose 20%, nga bashkëfinancimi i fermerëve, destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e mekanizmit tjetër bujqësorë'.

2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë sipas pikës një (1) të vendimit, nënpikave 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.8, 1.10, 1.11, 1.12, participojnë fermerët e komunës së Fushë-Kosovës, me mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 68,800.00€.

3. Kryerja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.oooo

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

____________________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 14
Datë/Datum. 02.02.2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 02.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 02, të datës 15.01.2016, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 62, të datës 16.05.2013 miraton:

## PLANIN VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS, KOMITETIT PËR POLITIKË E FINANCA DHE KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2016

1. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete përfshin punën dhe aktivitetet e parapara për vitin 2016.

2. Realizueshmëria e Planit Vjetor të Punës për vitin 2016 është:

2.1 Në muajin Janar 2016, në javën e katërt, janë mbajtur mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës dhe janë shqyrtuar:

2.1.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.1.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.1.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale, të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.1.4 Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete për vitin 2016;
2.1.5 Të ndryshme.

2.2 Në muajin Shkurt 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.2.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.2.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.2.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;

2.2.4 Informatë e KKSB-së për sigurinë në komunikacion, me theks të veçantë në krijimin e një plani të veprimit, për rritjen e sigurisë në trafik nga pjesëmarrësit në komunikacion;
2.2.5 Shqyrtimi i propozimit për bartjen dhe shpërndarjen e të hyrave vetjake të vitit 2015, në vitin 2016;
2.2.6 Raporti përfundimtar Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015;
2.2.7 Propozim për formimin e Komisionit, për hartimin e Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenve e maceve dhe mënyrën e veprimit, në rast të braktisjes ose humbjes së tyre;
2.2.8 Të ndryshme.

2.3 Në muajin Mars 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.3.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.3.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.3.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.3.4 Raporti përfundimtar Vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2015;
2.3.5 Shqyrtimi i Raportit përfundimtar vjetor financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2015;
2.3.6 Informatë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për aktivitetet e saj;
2.3.7 Të ndryshme.

2.4 Në muajin Prill 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.4.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.4.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.4.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.4.4 Shqyrtimi i raportit financiar për ekzekutimin e buxhetit të planifikuar për periudhën Janar/Mars 2016;
2.4.5 Propozim për formimin e Komisionit, për hartimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;
2.4.6 Informatë e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, për pronën e paluajtshme komunale dhe shqyrtimi i mundësive të dhënies së saj me qira;
2.4.7 Informatë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për punën dhe aktivitetet e saj;
2.4.8 Informatë e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, për gjendjen e përgjithshme në lagjet e banuara nga komunitetet: Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian, si dhe adresimi për shqyrtim i kërkesave të këtyre komuniteteve, të parashtruara në Komitetin për Komunitete, në muajin Dhjetor 2015, për zgjidhje në përputhje me mundësitë buxhetore të komunës gjatë vitit 2016;
2.4.9 Të ndryshme.

2.5 Në muajin Maj 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.5.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.5.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.5.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.5.4 Shqyrtimi dhe miratimi i 'Planit dinamik për organizimin e Dëgjimeve Publike për buxhetin e vitit 2017';
2.5.5 Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2016;
2.5.6 Shqyrtimi i propozimeve për shpalljen e 'Qytetar Nderi', për vitin 2016;
2.5.7 Informatë e Drejtorisë për Arsim për rrjedhën e vitit shkollor 2014/2015 dhe përgatitjet e nxënësve për testet e semimaturës dhe maturës shtetërore;
2.5.8 Informatë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për punët tekniko-formale dhe shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe punëve dhe aktiviteteve në Qendrën për Punë Sociale, me theksim në rastet sociale;
2.5.9 Të ndryshme.

2.6 Në muajin Qershor 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.6.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.6.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.6.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.6.4 Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019;
2.6.5 Informatë e Drejtorisë së Planifikim Urban për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planeve Urbane, me theksim të veçantë në procesin e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje;
2.6.6 Informatë e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis për punën dhe hapat e paraparë për punë dhe intervenime në terren gjatë stinës verore, me theksim të veçantë në sistemin e furnizimit me ujë dhe ndriçimin publik;
2.6.7 Të ndryshme.

2.7 Në muajin Korrik 2016, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.7.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.7.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.7.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;

2.7.4 Raportimi i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës për periudhën gjashtëmujore;
2.7.5 Shqyrtimi i raportit financiar për ekzekutimin e buxhetit të planifikuar për periudhën Prill/Qershor 2016;
2.7.6 Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2015;
2.7.7 Informatë e Drejtorisë për Inspektorat për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për inspektim;
2.7.8 Informatë për punën e. Komisionit Aksionar në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi", për territorin e komunës tonë;
2.7.9 Të ndryshme.

2.8 Muaji Gusht 2016, është muaji i pushimeve verore të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve. Në muajin Shtator 2016, në javën e parë, mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e dytë mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.8.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.8.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.8.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.8.4 Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017;
2.8.5 Informatë e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për zbatimin e programit për zhvillimin e agrobiznesit, me theksim në informim për realizimin e korrje-shirjeve për vitin 2016 dhe ofrimin e të dhënave për mbjelljet e kulturave bujqësore;
2.8.6 Të ndryshme.

2.9 Në muajin Shtator 2016, në javën e tretë mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.9.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.9.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.9.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.9.4 Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2017;
2.9.5 Të ndryshme.

2.10 Në muajin Tetor 2016, në javën e tretë mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.10.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.10.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;

2.10.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.10.4 Shqyrtimi i raportit financiar për ekzekutimin e buxhetit të planifikuar për periudhën Korrik/Shtator 2016;
2.10.5 Informatë e shkurtër e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e planit vjetor të punës;
2.10.6 Informatë e shkurtër e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën;
2.10.7 Propozim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor për punën e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2017;
2.10.8 Të ndryshme.

2.11 Në muajin Nëntor 2016, në javën e tretë mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.11.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.11.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.11.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.11.4 Informatë për punën e. Komisionit Aksionar në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi", për territorin e komunës tonë;
2.11.5 Të ndryshme.

2.12 Në muajin Dhjetor 2016, në javën e tretë mbahen mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:

2.12.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2.12.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
2.12.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
2.12.4 Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor për punën e Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2017;
2.12.5 Të ndryshme.

3. Për zbatimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2016, kompetent është Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

4. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016 hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**
__________________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 15
Data/Datum 03.02.2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

---

**Datë: 02.02.2016**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 31, të datës 18.01.2016, paraqitur nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, për zbatimin e detyrimeve komunale që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës, Nr. 98, të datës 17.08.2012 mori:

# V E N D I M
## PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RIINTEGRIM PËR VITIN 2016

1. Me këtë vendim miratohet, 'Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim për vitin 2016 i Komunës së Fushë-Kosovës'.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim i Komunës së Fushë-Kosovës, i hartuar nga Grupi Punues për hartimin e Planit Lokal të Riintegrimit.

3. Për zbatimin e këtij Plani obligohen të gjithë Institucionet Komunale, ndërsa monitorimin e zbatimit e bënë Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

_______________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 15
Datë/Datum. 03. 02. 2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

# Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim

## Përmbajtja

### Objektivat

1. Fuqizimi i kapaciteteve komunale për riintegrim
2. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel horizontal dhe vertikal
3. Sigurimi i shërbimeve të garantuara me politikat e riintegrimit
4. Vetëdijesimi publik dhe mobilizimi social
5. Funksionalizimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit (SMR)

**Legjenda:**

* Strategjia nacionale për riintegrimin e personave të riatdhesuar

** Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar

*** Rregullorja nr. 08/2015 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit

**** Udhëzuesi për ndihmë dhe mbështetje të personave të riatdhesuar për riintegrim të qëndrueshëm

***** Doracaku për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare

| | Objektivi | | Aktivitetet | Masat | Afati Kohor | | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Indikatorët e Suksesit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Fuqizimi i kapaciteteve komunale për riintegrim** | 1.1 | Vlerësimi i kapaciteteve komunale për shërbimet e riintegrimit | • Hartimi i instrumenteve matëse për vlerësim të kapaciteteve komunale (intervista, pyetësori)<br>• Ananliza e kapaciteteve komunale për riintegrim | K1 –janar – dhjetor 2016 | | K.A | Njësia e personalit dhe ZKKK | • Vlerësimi i performancës |
| | | 1.2 | Fuqizimi në kontinuitet i zyrave komunale, bazuar në analizën e kapaciteteve ekzistuese | • Rekrutimi i stafit shtesë sipas nevojës<br>• Ricaktimi/plotësimi nga stafi i brendshëm | Në vazhdimësi | | Buxheti Komunal | Zyra e Kryetarit dhe njësia e personelit | • Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |
| | | 1.3 | Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit komunal | • Shpërndarja e formularëve të vlerësimit të nevojave të stafit<br>• Plotësimi i formularit nga stafi | K2 – Në vazhdimësi | | K.A | Institucionet përkatëse | • Përmirësimi i performancës |
| | | 1.4 | Ofrimi i trajnimeve bazuar në nevojat e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim | • Analizë e nevojave për trajnime<br>• Përgatitja e planit të trajnimeve<br>• Realizimi i trajnimeve të nevojshme për stafin | Në vazhdimësi | | Buxheti Komunal dhe donatorët | Institucionet përkatëse | • Realizimi i trajnimeve |
| | | 1.5 | Vlerësimi iperformancës së stafit | • Vlerësimi i rregullt i rezultatit të punës sipas raporteve të rregullta të punës | Në vazhdimësi | | KK | Zyra e Kryetarit dhe njësia e personelit. | • Raportet e punës tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore |

| | Objektivi | | Aktivitetet | Masat | Afati Kohor | | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel horizontal dhe vertikal** | 2.1 | Vendosja e pikave të kontaktit për riintegrim | • Kontaktet e Zyrës për Komunitete dhe Kthim dhe Qendrës për Punë Sociale | Në vazhdimësi | | K.A | ZKKK<br>DKA<br>QPS | • Raportet për nivelin e bashkëpunimit |
| | | 2.2 | Bashkëpunimi i ZKK-e me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Qendrën për Punë Sociale, për vlerësimin e nevojave të personave të riatdhesuar dhe sigurimi i shërbimeve sociale gjatë procesit të riintegrimit | • Njoftimi i Qendrës për Punë Sociale dhe Drejtorinë e Arsimit për familjet dhe fëmijët e riatdhesuar<br>• Vizitat e përbashkëta në familje për vlerësimin e nevojave<br>• Ofrimi i shërbimeve të nevojshme, bazuar në nevojat e identifikuara. | Në vazhdimësi | • | K.A. | ZKKK<br>Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR) | • Raportet periodike të ZKKK dhe ofrimi i informatave të tjera |
| | | 2.3 | Bashkëpunimi i ZKK-e me Zyrën e Gjendjes Civile (QKRC) për regjistrimin civil për pajisje me dokumente personale të personave të riatdhesuar | • Referimi i rasteve në Zyrat e Gjendjes Civile për Regjistrim Civil<br>• Referimi i rasteve për pajisje me dokumente civile | Në vazhdimësi | • | K.A. | ZKKK<br>Zyra për Gjendje Civile | •Publikimi i dokumenteve të nxjerra nga ZKKK dhe nga Drejtoria e Administratës (Zyra e Gjendjes Civile ) për persona të riatdhesuar |
| | | 2.4 | Bashkëpunimi i ZKK-e me Drejtorinë e Arsimit për regjistrimin nxënësve në shkolla fillore dhe të mesme. Udhëzimi për nostrifikimin e dokumenteve, organizimin e kurseve të gjuhës për fëmijët e riatdhesuar | • Dërgimi i listave të fëmijëve për regjistrim në shkolla nga ZKKK për DKA<br>• Identifikimi i fëmijëve me nevoja për kurse të gjuhës<br>• Organizimi i kurseve të gjuhës<br>• Udhëzimi i palëve për nevojat e nostrifikimit të dokumenteve | Në vazhdimësi | • | K.A. | DKA<br>MASHT<br>ZKKK<br>DRPR<br>Donatorët | •Publikimi i rasteve të rikthyer në procesin e edukativo – arsimor. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.5 | Bashkëpunimi i ZKK-së me zyrat komunale të punësimit, QAP-at për punësim, aftësim profesional dhe themelim të bizneseve të personave të riatdhesuar | • Referimi i personave të riatdhesuar për regjistrim në zyrat komunale të punësimit si punëkërkues<br>• Referimi i personave të riatdhesuar në QAP | Në vazhdimësi | • | K.A. | ZKKK<br>QAP<br>MPMS<br>Drejtoritë Komunale<br>OJQ dhe donatorët | •Publikimi i rasteve/ numri i personave të regjistruar si të papunë dhe numrin e rasteve të punësuar<br>•Publikimi i rasteve të personave të aftësuar në QAP |
| | | 2.6 | Bashkëpunimi i zyrave dhe drejtorive komunale me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që trajtojnë çështjet e riintegrimit | • Takimet e rregullta<br>• Organizimi i konferencave<br>• Organizimi i forumeve të përbashkëta<br>• Implementimi i projekteve të përbashkëta | Në vazhdimësi | • | K.A. | ZKKK<br>DKA<br>OJQ ndërkombëtare dhe lokale | •Numri i takimeve të rregullta<br>•Numri i forumeve të përbashkëta<br>•Numri i projekteve të përbashkëta të implementuara |
| | | 2.7 | Bashkëpunimi i ZKKK-ve me DRPR-për çështje të riintegrimit | • Kontaktet e rregullta me koordinatorë (ZLKR).<br>• Pjesëmarrja në takimet e organizuara nga DRPR<br>• Raportimi i rregullt | Në vazhdimësi | • | K.A. | ZKKK<br>DRPR | •Numri i takimeve të rregullta<br>•Numri i raporteve të dërguara |
| | | 2.8 | Bashkëpunimi i ZKKK-e, drejtorive me ministritë përkatëse dhe institucionet tjera me nivelin qendror për çështje të riintegrimit | • Kontaktet e rregullta në DRPR dhe ministritë përkatëse<br>• Pjesëmarrja në takimet e rregullta | Në vazhdimësi | • | | ZKKK<br>ministritë përkatëse | •Numri i raportimeve të shkëmbyera<br>•Numri i takimeve të përbashkëta |

| Objektivi | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 **Sigurimi i shërbimeve të garantuara me politikat e riintegrimit** | 3.1 | Vlerësimi i nevojave të personave (familjeve) të riatdhesuar | Vizita në familjet e kthyera / riatdhesuara | Në vazhdimësi | • K.A. | ZKKK QPS DRPR | • Numri i familjeve të vizituara |
| | | | Plotësimi i formularëve | Në vazhdimësi | • K.A. | ZKKK QPS DRPR | Numri i formularëve të plotësuar |
| | | | Identifikimi i nevojave në bazë të vlerësimit dhe përgatitja e planeve individuale të riinttegrimit | Në vazhdimësi | • K.A. | ZKKK QPS DRPR | Raporti për vlerësimin e familjeve të vizituara<br>Numri i planeve individuale të riintegrimit |
| | 3.2 | Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe medikamente | Sigurimi i trajtimit mjekësor dhe medikamenteve për rastet në nevojë | Në vazhdimësi | • Programi i Riintegrimit | MPMS MSH DSHMS | • Numri i përfituesve |
| | 3.3 | Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale | Caktimi i specialistit për shërbime psikosociale nga Qendra për Mirëqenie Sociale për ofrimin e shërbimeve për rastet në nevojë | Në vazhdimësi | • Programi i riintegrimit | MSH QPS DRPR | -Përzgjedhja e rasteve për shërbime psikosociale në komunë<br>- Numri i shërbimeve të ofruara |
| | | | Ofrimi i shërbimeve psikosociale dhe familjare | Në vazhdimësi | • Programi i riintegrimit | MSH | • Numri i shërbimeve të ofruara |
| | | | Ofrimi i ndihmës së rastit për grupet e cenueshme | Në vazhdimësi | • Programi i riintegrimit | MPMS DRPR MSH M.P.B | • Numri i shërbimeve të ofruara |
| | | | Asistenca sociale e familjeve në nevojë | Në vazhdimësi | Programi i riintegrimit | ZKKK QPS | -Numri i shërbimeve të ofruara |
| | 3.4 | Qasja në Arsimim Formal dhe Joformal | Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të arsimimit. | Në vazhdimësi | • K.A | DKA MASHT ZKKK | • Nevojat e vlerësuara |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ofrimi i mësimit plotësues për nxënësit në nevojë | Në vazhdimësi | • | Programi i riintegrimit | MASHT<br>DKA<br>DRPR | • Numri i nxënësve të përfshirë në mësim plotësues |
| | | | Nostrifikimi i dëftesave dhe diplomave | Në vazhdimësi | • | K.A | MASHT | • Numri i diplomave dhe dëftesave të nostrifikuaranga MASHT |
| | | | Programet joformale të arsimimit | Në vazhdimësi | • | Programi i riintegrimit | DKA<br>MASHT | Numri i pjesëmarrësve në program |
| | 3.5 | Riintegrimi ekonomik i të riatdhesuarve | Regjistrimi i të riatdhesuarve si punëkërkues | Në vazhdimësi | | K.A | DRPR<br>MPMS | • Numri i të regjistruarve si punëkërkues |
| | | | Profilizimi i kandidatëve | | | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | • Identifikimi i kapaciteteve |
| | | | Ofrimi i shërbimeve të punësimit | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | • Numri i shërbimeve të orfuara |
| | | | Ofrimi i aftësimeve profesional | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | • Numri i përfituesve të aftësimeve profesionale |
| | | | Financimi i planeve të biznesit | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | • Numri i përfituesve të planeve të biznesit |
| | | | Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrësi | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | • Numri i trajnimeve të ofruara<br>• Numri i përfituesve të trajnimeve |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sigurimi i konsulentës për përfituesit e bizneseve | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR MPMS | •Numri i shërbimeve të ofruara |
| | 3.6 | Banimi i qëndrueshëm | Sigurimi i banimit me qira | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit. | MMPH MPB | •Numri i përfituesve |
| | | | Sigurimi i pakos dimërore | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | DRPR | •Numri i përfituesve |
| | | | Sigurimi i banimit përmes rindërtimit apo renovimit | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | MMPH MPB | -Në vazhdimësi |
| | | | Sigurimi i mobilieve | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | MPB | - |
| | | | Ndërtimi i banesave kolektive me bashkëfinancim | Në vazhdimësi | | Programi i riintegrimit | MMPH Donatorët | -Numri i përfituesve |

| | Objektivi | | Aktivitetet | Masat | Afati Kohor | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Vetëdijesimi publik dhe mobilizimi social** | 4.1 | Informimi i personave të riatdhesuar për përfitimet dhe të drejtat e tyre | Shpërndarja e Fletëpalosjeve informative | Në vazhdimësi | Programi i riintegrimit | ZKKK | • Fletëpalosjet e shpërndara në të gjitha pikat e kontaktit me të riatdhesuarit |
| | | | | Organizimi i fushatave informuese për mundësinë e përfitimit | Në vazhdimësi | Programi i riintegrimit | ZKKK dhe institucionet komunale | • Numri i fushatave informative |
| | | 4.2 | Vendosja e kartës standarde të shërbimeve të riintegrimit | Fletëpalosjet e shpërndara në të gjitha pikat e kontaktit të riatdhesuarve | K1-2016 | K.A. | ZKKK | Karta e vendosur në ZKKK |
| | | 4.3 | Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për ofrimin dhe zhvillimin e programeve të riintegrimit | Takimet me ON për zhvillimin e programeve të riintegrimit | Në vazhdimësi | K.A. | Zyra e Kryetarit ZKIE | Numri i takimeve me ON |
| | | | | Ofrimi i shërbimeve të riintegrimit në bashkëpunim me shoqërinë civile | Në vazhdimësi | K.A. | ZKKK | Shërbimet e ofruara në bashkëpunim me shoqërinë civile |

| Objektivi | | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | **Funksionalizimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit (SMR)** | 5.1 | Mirëmbajtja dhe ngritja e SMR në nivel Lokal | Mbështetje e vazhdueshme për monitorimin e sistemit të SMR | Në vazhdimësi | K.A. | ZKKK | • Zyrtari përgjegjës |
| | | 5.2 | Regjistrimi i vazhdueshëm i rasteve dhe arkivimi i dokumenteve në SMR | Regjistrimi i rasteve në SMR, skanimi dhe vendosja e dosjeve, dokumenteve dhe vendimeve në SMR, regjistrimi i rasteve të reja | Në vazhdimësi | K.A. | ZKKK | • Të gjitha rastet e regjistruara dhe të kompletuara në SMR |
| | | 5.3 | Monitorimi i rasteve përmes SMR-së | Monitorimi i mbështetjes dhe ndihmës të riatdhesuarve<br>Analiza e nevojave të identifikuara<br>Vlerësimi i nevojave të plotësuara | Në vazhdimësi | K.A. | ZKKK | • Rastet e monitoruara në vazhdimësi |
| | | 5.4 | Gjenerimi i raporteve të rregullta nga SMR-ja | Printimi i raporteve të rregullta nga SMR | Në vazhdimësi | K.A. | ZKKK | • Raportimi periodik |
| | | 5.5 | Përdorimi i të dhënave nga SMR në zhvillimin e politikave të riintegrimit në nivel lokal | • Analiza e situatës<br>• Përgatitja e rekomandimeve bazuar në rezultatet e analizës<br>• Zhvillimi i vazhdueshëm i politikave | Në vazhdimësi | K.A. | Komuna dhe ministria përkatëse | • Avancimi i politikave në vazhdimësi |

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi